

VENDIM
Nr. 44, datë 13.6.2018

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS- KANALIZIME KURBIN

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe Rregullores së licencimit, miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kurbin sh.a., për rinovim licence dhe për efekt të shtimit të kategorisë së shërbimit të largimit të ujërave të ndotura, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës Kurbin është licencuar me vendim të KKRR-së nr. 39, datë 23.9.2016, për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me ujë për konsum publik me afat 4-vjeçar.

- Me anë të shkresës nr. 259 prot., datë 10.5.2018, shoqëria paraqet kërkesën për rinovim licence për efekt të shtimit të kategorisë së shërbimit për largimin e ujërave të ndotura, shtim të vlerës së kapitalit dhe ndryshim i emrit të shoqërisë;

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kurbin sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e licencimit, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- Janë bërë ndryshimet në dokumentin e QKB-së mbi emrin e subjektit dhe shtimi i objektit për aktivitetin e largimit të ujërave të ndotura;
- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjiellës-Kanalizime Kurbin sh.a., me:

Drejtues ligjor: Alfred Prodani;

Drejtues teknik: Julinda Elezi.

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Kurbin autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik;

Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori janë njësitë administrative të Bashkisë Kurbin, si më poshtë:

- a) Njësitë administrative: Laç;
- b) Mamurras;
- c) Milot.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

5. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 23.9.2016, “Për licencim sh.a. Ujësjiellës Kurbin”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani